



Npi – 01/343 datë: 31.12.2025

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur më 31.12.2025, ka nxjerrë këtë:

### E K S T R A K T P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme, e Kuvendit të Komunës së Shtimes,  
e mbajtur më datën 31.12.2025 (e mërkurë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi anëtari më i vjetër i Kuvendit z.Haqif Arifi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Mbledhjes z.Haqif Arifi, anëtarët e Kuvendit: z.Adnan Ademi, z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Halil Kurtishi, z.Zenel Shabani, znj.Yllkë Fejzullahu, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani z.Rahman Jakupi, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Syla, z.Bajram Hajrizi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Imri Hoxha-DAP; z.Bardhyl Rushiti -DSHP; Asistentja e Nënkryetarit znj.Gentiana Mehmeti; Nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi; Praktikantët: znj.Hava Llugaxhija, z.Albion Shabani, dhe znj.Teuta Mustafa si dhe qytetarë të tjerë. Për këtë seancë të Jashtëzakonshme është propozuar ky:

### R E N D I T E

1. Dhënja e Betimit të anëtarit të ri të Kuvendit z.Bajram Hajrizi,
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

**Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi:** Përshëndetje. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës si dhe Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve nga Kryetari i Komunës është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme. Po ashtu në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe në bazë të Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve si anëtari më i moshuar i kësaj legjislature, po e hapi këtë seancë. Gjatë kësaj seance si dhe senacës së kaluar kanë ndodhur disa ndryshime, ku një anëtarë i PDK-së është tërhequr dhe është plotësuar nga KQZ-ja me kandidatin tjetër. Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**\*Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pikal

Dhënja e Betimit të anëtarit të ri të Kuvendit z.Bajram Hajrizi

**Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi:** Në bazë të deklaratës së z.Jakup Ismajli i cili ka dhënë dorëheqje për arsye personale të tij, si dhe në bazë të deklaratës së z.Bajram Hajrizit, dhe vendimit të KQZ-së si dhe njoftimit që i është bërë nga KQZ-ja Kuvendit Komunal, anëtari z.Bajram Hajrizi sot duhet të japë betimin. E kisha lutë z.Bajram Hajrizin të ngritet në këmbë ose të dalë te foltorja dhe të jap Betimin Solemn para Kuvendit.

**z.Bajram Hajrizi:** Përshëndetje. Në vazhdim anëtar i Kuvendit z.Bajram Hajrizi e dha Betimin solem para Kuvendit.

**Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi:** Urime koleg, tani më veq se është bërë plotësimi me të gjithë kandidatët e Kuvendit Komunal. Ne po vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

## Pika2

### Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes

**Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi:** Hapi diskutimin për këtë pikë. Fjalën ja dha z.Adnan Ademi.

**z.Adnan Ademi:** Përshëndetje. Ju e dini që vitin e fundit kemi qenë në zgjedhje të njëpasnjëshme dhe para dy tre dite kemi dalur nga zgjedhjet e fundit. Dhe si subjekte politike kemi qenë të angazhuar me fushata që nga viti i kaluar deri më tani. Ne si LVV-ë kemi menduar që kjo seancë të shtyhet pasi që jemi në ditën e fundit të vitit dhe realisht dhe sot është një ditë që duhet të festohet dhe jemi të gjithë të angazhuar, dhe për shkakë që jemi të lodhur prej fushatës që ka kaluar dy tre ditë më herët propozojmë që kjo seancë të vazhdojë në mbledhje tjetër për zgjedhjen e Kryesuesit. Ne si LVV mendojmë që do të bëjmë një marrëveshje, meqenëse i kemi filluar negociatat me LDK-në dhe në dakordim me Kryetarin dhe anëtarët e Kryesisë si dhe me kolegët asambleistë jemi dakorduar që ta shtyjmë këtë seancë bashkarisht për një ditë tjetër që ta arrijmë një marrëveshje dhe ta funksionalizojmë Kuvendin ashtu siç e meriton, dhe të vazhdojmë vitin e ri me zgjedhjen e Kryesuesit të ri dhe marrjen e vendimeve në të mirën e qytarëve. Është mirë edhe për demokraci edhe për neve si kvendar që kjo seancë të shtyhet për një ditë tjetër.

**z.Rrahman Jakupi:** Përshëndetje. Ne si subjekt politik e kemi pranuar ftesën. Nëse brenda 30 dite nuk konstituohet Kuvendi i Komunës së Shtimes që i bije të zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit atëherë Kuvendi mund të shkojë në zgjedhje. Nuk e shoh të arsyeshme që të shtyhet kjo mbledhje, mirëpo duhet me pas parasysh që nëse nuk zgjidhet deri më datë 5 Janar atëherë Kuvendi i Komunës së Shtimes sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale mund të kalojë në pjesën ku duhet të shkohet në zgjedhje. Ky propozim nuk është i plotë, është i mangët dhe si i tillë ne abstenojmë në këtë vendim, mendojmë që Kryesuesi i Kuvendit mund të zgjidhet sot.

**z.Shefqet Krasniqi:** Pëshëndetje. I dëgjova këto propozime të dy subjekteve PDK dhe LVV. Do të doja të jepja mendimin lidhur me skadimin e afatve ligjore. Ne nuk po mbyllim këtë seancë, por po e vazhdojm për një seancë tjetër. Ne si LDK konsiderojmë meqenëse nuk ka marrëveshje politike, kjo seancë të vazhdojë për një ditë tjetër.

**z.Rrahman Jakupi:** Me sa e pash data e fundit është 3 Janar dhe jo 5 Janar.

**z.Adnan Ademi:** Ne jemi të vetëdijshëm për afatet ligjore, prandaj edhe është thirrur seancë e jashtëzakonshme. Askund në ligj e as udhëzim adminsitrativ nuk shkruan se Kuvendi shkonë në zgjedhje. Nëse seanca është thirrur sot dhe nuk ndërprehet atëherë ne kemi të drejtë ta zgjedhim Kryesuesin jo vetëm në seancën e ardhshme por edhe në tjetren sepse është vazhdimsi e kësaj seance. Dhe meqenëse nuk i kemi votat asnjë subjekt për me zgjedhë Kryesuesin atëherë duhet me pas një konsensual mes subjekteve politike. Pa merak për të gjithë kolegët brenda rregullave jemi seanca mund të vazhdojë një ditë tjetër.

**z.Rrahman Jakupi:** Një sqarim për anëtarët e Kuvendit në vazhdim lexoi nenin 50 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Kjo është njëra nga pikat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ku e konkretizon saktë që Kryesuesi i Kuvendit nëse nuk zgjidhet atëherë bëhet edhe shpërndarja e Kuvendit.

**z. Demokrat Mujota:** Përshëndetje. Ftesa është thirrur si mbledhje e jashtëzakonshme. Do të thotë ka ndodhur ndonjë gjë, ndonjë ngjarje dhe është diçka e jashtëzakonshme që duhet ne të mblidhemi për me votuar Kryesuesin e Kuvendit. Por kur vimë në Kuvend e shohim se nuk qenka bash e jashtëzakonshme dhe mund të vazhdohet ndonjë ditë tjetër. Ne jemi mësuar me politikat e konceptimit të LVV-së se si e sheh funksionimin e institucioneve. Nuk shkohet deri në nivele ku rrezikohet edhe dështimi i shtetit. Ne e kemi afatin ligjor deri më 3 Janar. Partitë

politike nëse nuk e kanë Kryesuesin, PDK-ja e ka Kryesuesin, e hedhim në votim dhe kush fiton le të fiton, kush humb humb në rregull jemi.


**z.Muhamet Ademaj:** Përsheëndetje. Unë si Anëtar i Pavarur i Kuvendit ndëgjova dhe e pash që as një subjekt politik nuk e kanë shumicën e votave për me zgjedhë Kryesuesin, është mirë që të ju japim një mundësi që subjektet politike duke filluar nga LVV, PDK dhe LDK të ulën dhe të bisedojnë që ai kandidatë që del nga propozimi të zgjidhet si Kryesues i Kuvendit. Unë në këtë rast nuk jam as për po as për jo.

**Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi:** Ne jemi të vetëdijshëm për atë që është diskutuar këtu, ashtu është edhe në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale ku paragrafi i parë e thotë në mënyrë të qartë që duhet brenda 30 dite të zgjidhet Kryesuesi, i kam pararysh të gjitha këto. Pa humbur kohë shkojmë me propozimin e parë që është nga LVV-ja, që kjo mbledhje të shtyhet për një datë tjetër.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 7 vota “Abstenim”, miratoi Propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje që mbledhja e Jashtëzakonshme më datë 31.12.2025 të shtyhet për datën 03.01.2026 në ora 14:00h.**

**Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi:** Pasi që diskutime tjera nuk ka, Konstatoj se kjo mbledhje e Jashtëzakonshme do të vazhdojë më datën 03.01.2026 në ora 14:00h.

Procesmbajtëse  
Sadberë Halili



Kryesuesi i Mbledhjes  
Haqif Arifi

